



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 537/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Trajner Sportiv, MA, 60 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Trajner Sportiv, MA, 60 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Trajner Sportiv	MA	60	Musa Selimi, Bujar Turjaka, dhe Bylbyl Sokoli

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit më 26.04.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Karen Petry dhe Dusan Hamar.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë